

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar kolegji, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses N.T. “Ballkani” me seli në Ferizaj, kundër të paditurës “Byroja Kosovare e Sigurimeve” (BKS) me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe fitimit të munguar, në shumën e përgjithshme prej 11,044.00 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të parashtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr. 83/2016 të datës 22.04.2016, me datë 19.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr. 83/2016, i datës 22.04.2016, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpapia e paditësit N.T. “Ballkani” dhe në pikën I të dispozitivit është detyruar e paditura BKS që paditëses t`ia paguaj shumën e përgjithshme prej 11,044.00 €, në emër të borxhit kryesor për kompensimin e dëmit material të pësuar në automjetin e aksidentuar shumën prej 9,360.00 € dhe në emër të fitimit të munguar shumën prej 1,680.00 €, me kamatë sipas normës vjetore prej 12%, e cila do të llogaritet nga data e ekspertizës dt. 05.09.2014 deri në pagesën përfundimtare. Në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t`ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,345.06 €.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i goditur të prishet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 505.1 të LPK-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja me padinë e ushtruar me datë 12.08.2013 ka kërkuar nga gjykata që në emër të zhdëmtimit material sipas bazës së auto përgjegjesisë për dëmin

e pësuar si pasojë e aksidentit të datës 19.06.2013, në magjistralen Ferizaj-Gjilan, në të cilin është dëmtuar automjeti i paditëse, i markës “Kassboher” me targa 05-488-AB. Meqenëse shkaktar i aksidentit ishte vozitësi i automjetit për transportimin e mallrave me targa BU 008 UT, me rimorkio me targë 00 006 BU, pronari i të cilit ka pasur sigurimin kufitar të detyruar të auto përgjegjësishë tek e paditura ka kërkuar nga gjykata që ta detyrojë të paditurën që në emër të dëmit material dhe fitimit të munguar t’ia paguaj shumën prej 11,044.00 €, dhe atë në emër të dëmit në automjetin e aksidentuar shumën prej 9,360.00 € dhe në emër të fitimit të munguar shumën prej 1,680.00 €, me kamatë ligjore prej 12%, e cila do të llogaritet nga data e ekspertizës dt. 05.09.2014 deri në pagesën përfundimtare.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit meqenëse e paditura nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë, përkatësisht ka pranuar përgjegjësinë për bazën juridike të kompensimit e dëmit, por e ka kontestuar vetëm lartësinë e kompensimit të kërkuar. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e vet e ka mbështetur në konstatimin e ekspertit të makinerisë, për vlerësimin e dëmit N.Sh., të dhënë në ekspertizën teknike të datës 05.09.2014 dhe plotësimin e datës 13.10.2014, sipas të cilit ka rezultuar se lartësia e dëmit të pësuar, saktësisht kostoja e riparimit të automjetit, është në shumën prej 9,360.00 €, ndërsa fitimin e munguar e ka llogaritur sipas mesatares së një auto-dite për autobusë ndër urban përkatësisht 80,000.00 € X 25 ditë = 1,680.00 €, andaj gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 173 dhe 174 të LMD-së, të cilën parashohin se: *“i dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar dhe se dëmi duhet të kompensohet në mënyrë të plotë ashtu që gjendja materiale e dëmtuesit të sjellët atje ku do të ishte po të mos kishte veprim dëmtues”*, andaj bazuar në këto dispozitë, e aprovoi edhe kërkesën për kompensimin e fitimit të munguar në shumën e gjykuar si në dispozitiv. Lartësinë e shumës së gjykuar për kompensimin e dëmit për fitimin e përcaktuar (fitimin e munguar) në shumë prej 1,680.00 €, gjykata e shkallës së parë e ka përcaktuar në bazë të mendimit dhe konstatimit të Ekspertit N.Sh., i cili lartësinë e fitimit të munguar e ka përcaktuar në bazë të standardeve të krijuara respektivisht në bazë të mesatares së një auto-dite për autobusë ndër urban përkatësisht 80.00 € për ditë. Ketë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë, e pranon edhe Gjykata e Apelit pasi konsideron se nuk është e domosdoshme caktimi i ekspertizës së aktuaristikës për përcaktimin e lartësisë së fitimit të munguar, në rast të ekzistimit të standardeve të caktuara për atë çështje, sepse nuk do të ishte ekonomikisht e arsyeshme caktimi i ekspertizës për shumën kontestuese nëse lartësia

e fitimit të humbur mund të përcaktohet në mënyrë tjetër, si në rastin konkret. Mbi këtë bazë, Gjykata e Apelit e vlerëson si të pabazuara pretendimet ankimore lidhur me përcaktimin e lartësisë së fitimit të munguar.

Gjykata e shkallës së dytë i vlerësoi pretendimet ankimore të të paditurës lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me rastin e vendosjes për kamatën prej 12%, dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, sepse me dispozitën e nenit 919 të LMD-së është përcaktuar se: *1 "Kur të ketë ndodhur rasti i siguruar, siguruksi ka për detyrë të paguajë shpërblimin ose shumën e caktuar me kontratë në afatin e kontraktuar, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se katërmbëdhjetë ditë, duke llogaritur që nga data kur siguruksi të ketë marrë njoftimin se ka ndodhur rasti i siguruar".2 "Mirëpo, në qoftë se për caktimin e ekzistimit të detyrimit të siguruksit ose të shumës së tij nevojitet një kohë, ky afat fillon të rrjedhë nga dita kur është vërtetuar ekzistimi i detyrimit të tij dhe shuma e tij."* Po ashtu gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë i ka zbatuar dispozitat e nenit 26 pika 6, të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, i cili përcakton lartësinë e kamatës prej 12% nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Në rastin konkret rezulton se gjykata e shkallës së parë ka detyruar të paditurën për kompensim së bashku me kamatën duke llogaritur nga data e ekspertizës teknike të ekspertit të komunikacionit, përkatësisht nga data e përcaktimit të lartësisë së kompensimit, datë 05.09.2014.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës të shkallës së parë, në këtë pjesë nuk ka të meta për shkak të se cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, nuk është përfshirë më ndonjë shkelje e cila do të ishte me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ae.nr. 209/2016 data 19.03.2018

KRYETARI I KOLEGJIT- GJYQTARI
Mahir Tutuli d.v.